



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 30
Prishtinë, më 29 gusht 2011

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29 GUSHT 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm 83 deputetë dhe deklaroi të hapur punimet e sesionit vjeshtor të Kuvendit.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht, ka vendosur t'i propozojë Kuvendit që në mbledhjen e sotme, në vend të shqyrtimit të parë të Projektligjeve, të procedohet me shqyrtimin e dytë të 14 projektligjeve, të cilat janë me prioritet dhe të parapara me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian.

Kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare lidhur me këtë propozim.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Adem Graboci**, deklaroi se mbështetin propozimin e Kryesisë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Ismet Beqiri**, deklaroi se mbështetin propozimin e Kryesisë.

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, **Visar Ymeri**, deklaroi se nuk e mbështetin propozimin e Kryesisë.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, deklaroi se nuk e mbështetin propozimin e Kryesisë.

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, **Myzejene Selmai**, deklaroi se mbështetin propozimin e Kryesisë.

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Sasha Milosavljeviq**, deklaroi se mbështetin propozimin e Kryesisë.

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, **Rasim Demiri**, deklaroi se mbështetin propozimin e Kryesisë.

Pas këtyre deklarimeve, kryetari hodhi në votim propozimin e Kryesisë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----25,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi propozimin e Kryesisë që në mbledhjen e sotme të procedohet me shqyrtimin e dytë të projektligjeve.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale,

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për persona të zhdukur.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: **Valbona Dibra, Xhevdet Neziraj, Rexhep Selimi, Hashim Deshishku, Duda Balje, Halit Krasniqi, Glauk Konjufca, Emilja Rexhepi, Armend Zemaj, Nait Hasani dhe Shaip Muja**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas deklarimeve të deputetëve, kryeministri i Kosovës, **Hashim Thaçi** dha sqarime lidhur me çështjet që ngritën deputetët.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Haki Demolli**, parashtroi pyetje për ministrin të Financave lidhur mosngritjen e pensioneve.

Ministri **Bedri Hamza** iu përgjigj pyetjes së deputetit Demolli.

Deputeti **Liburn Aliu**, parashtroi pyetje për ministrin të Financave lidhur me vonesën e pagesave për shërbyesit civilë të komunës së Gjilanit.

Ministri **Bedri Hamza** iu përgjigj pyetjes së deputetit Aliu.

Deputeti **Visar Ymeri**, parashtroi pyetje për ministrin të Financave lidhur me planin e Qeverisë për rishikimin e buxhetit Kosovës, për vitin 2011.

Ministri **Bedri Hamza** iu përgjigj pyetjes së deputetit Ymeri.

Pas kohës për pyetje parlamentare, kryetari procedoi me shqyrtimin e dytë të projektligjeve.

Deputetët e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” lëshuan mbledhjen, me arsyetimin se nuk ishin prajtur me ndryshimin e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës

Kryesuesi, **Xhavit Haliti** i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Arsim, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media kanë shqyrtuar Projektligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Arsim e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti **Idriz Vehapi**, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e deputetit Vehapi, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35 dhe 36.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 77,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Arsim, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media kanë shqyrtuar Projektligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Arsim e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti Idriz Vehapi, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e deputetit Vehapi, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara të komisionit funksional, të Grupit Parlamentar "6+", të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re dhe të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje".

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 13, 14(a), 15, 16, 17, 18, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35 dhe 36.

Kuvendi nuk miratoi amendamentet: 7, 8, 14(b) dhe 19.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 68,
Kundër-----2
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Pas miratimit të këtij Projektligji, kryesuesi dha pauzë dreke deri në orën 15:00.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Arsim, Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media kanë shqyrtuar Projektligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 53,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri kanë shqyrtuar Projektligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të Konformitetit dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti **Zenun Pajaziti**, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e deputetit Pajaziti, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 dhe 25.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	60,
Kundër-----	0
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar Projektligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, deputetja Safete Hadërgjonaj, e cila kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kryetari i Grupit Parlamentare të LDK-së, deputeti **Ismet Beqiri**, kërkoi që në amendamentin nr. 5, ku thuhet: "përfshirë nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit 26, kontratat e prokurimit nuk nënshkruhen nga Presidenti i Kosovës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri i Kosovës", të shtohet: "edhe kryetarët e komunave".

Lidhur me këtë propozim diskutuan disa deputetë, të cilat janë dhënë në transkript.

Kryeministri i Kosovës, **Hashim Thaçi**, tha se në emër të Qeverisë së Kosovës, si propozuese e këtij projektligji, propozoi që paragrafi 3 i amendamentit 5 të hiqet, ndërsa të mbetet si është përpiluar në projektligj.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5 (variantin e propozuar nga Qeveria), 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15, 16.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 44,
Kundër-----0
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Në mungesë të kuorumit, kryesuesi mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 16:50 minuta, për t'i vazhdua punimet të mërkurën, më 31 gusht 2011, në orën 10:00.

E mërkurë, më 31 gusht 2011 **Vazhdim i mbledhjes plenare**

Mbledhjen e kryesoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Në fillim të mbledhjes, kryeministri i Kosovës, **Hashim Thaçi**, i njoftoi deputetët e Kuvendit lidhur me zhvillimet e fundit në veriun e Kosovës. Fjalimi i kryeministrit është dhënë në transkript.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që të rivotohet amendamenti nr. 5 i Projektligjit për prokurorimin publik në Republikën e Kosovës. Do ta mbështesim propozimin që të hiqet paragrafi 3 nga ky amendament dhe të mbetet siç ka qenë në projektligj.

Kryesuesi kërkoi deklarimin e Grupeve Parlamentare lidhur me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Pas deklarimit të grupeve parlamentare, kryesuesi hodhi në rivotim amendamentin nr. 5. pa paragrafin 3. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----54,
Kundër-----2,
Abstenime-----19.

Kryesuesi, pastaj hodhi në votim Projektligjin, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----91,
Kundër-----1,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Pastaj, u procedua me shqyrtimin e dytë të projektligjeve.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Legjislacion e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e informatorëve dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Legjislacion e arsyetoi kryetari këtij komisioni, deputeti **Arben Gashi**, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e deputetit Gashi, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 85,
Kundër-----1,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen e informatorëve.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Legjislacion e kanë shqyrtuar Projektligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Legjislacion e arsyetoi kryetari këtij komisioni, deputeti **Arben Gashi**, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e deputetit Gashi, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 72,
Kundër-----1,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Legjislacion e kanë shqyrtuar Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Legjislacion e arsyetoi kryetari këtij komisioni, deputeti **Arben Gashi**, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e deputetit Gashi, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2 dhe 3.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 71,
Kundër-----0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Legjislacion e kanë shqyrtuar Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Legjislacion e arsyetoi kryetari këtij komisioni, deputeti **Arben Gashi**, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e deputetit Gashi, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2 dhe 3.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76,
Kundër-----0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Legjislacion e kanë shqyrtuar Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Legjislacion e arsyetoi kryetari këtij komisioni, deputeti **Arben Gashi**, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e deputetit Gashi, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69,
Kundër-----0,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri kanë shqyrtuar Projektligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, **Zenun Pajaziti**, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion, **Arben Gashi**, tha se ky komision, për shkak të kohës së shkurtër, nuk ka arritur që t'i shqyrtojë tri projektligjet në vijim dhe nuk kanë qëndrim lidhur me to.

Lidhur me këtë diskutuan: zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi**, deputetët **Teuta Sahaqija**, **Visar Ymeri**, **Adem Grabovci**, **Muhamed Mustafa**, **Sabri Hamiti** dhe **Hydajet Hyseni**, që janë dhënë në transkript.

Kryesuesi kërkoi deklarimin e Kuvendit për procedimin e tri projektligjeve, të cilat nuk i kishte shqyrtuar Komisioni për Legjislacion. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër-----17,
Abstenime----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendit, me shumicë votash, vendosi të procedohet me shqyrtimin e tri projektligjeve, në vijim.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2 (pa paragrafin 12 të nenit 3), 3, 4, 5 dhe 6.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70,
Kundër-----16,
Abstenime----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri kanë shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti **Zenun Pajaziti**, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të deputetit Bekim Haxhiu.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 5(a), 6(a), 7, 9(a), 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Kuvendi nuk miratoi amendamentet: 4, 5(b), 6(b), 8 dhe 9(b).

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 62,
Kundër-----10,
Abstenime----- 19.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri kanë shqyrtuar Projektligjin për masat mbrojtëse në importe dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti **Zenun Pajaziti**, i cili kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 75,
Kundër-----1,
Abstenime----- 7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për masat mbrojtëse në importe.

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për persona të zhdukur

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet e përhershme dhe Komisioni funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e kanë shqyrtuar Projektligjin për persona të zhdukur dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, deputetja **Suzan Novorberdaliu**, e cila kërkoi nga deputetët t'i miratojnë amendamentet e propozuara nga komisioni funksional.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga komisioni funksional dhe deputetja **Albana Gashi**.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 77,
Kundër-----5,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për persona të zhdukur.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale